

Nr. 3446 Prot.
Datë 09.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS PARË
LUSHNJE

2- Informacionet



Nr. 3236/1669 Akti

Lushnje më 25.11.2025

L E N D A:

NJOFTIM AFISHIM ME SHPALLJE

DREJTUAR: -Bashkisë - Delvinë

ADRESA: 1. Parashqevi Vejtati, banuese në Delvinë, lagjia "9 Tetori"

Për dieni: Bashkia Delvinë
Punonjësja IT pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë
Lushnje

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje është duke u gjykuar çështja administrative që i përket palëve:

PADITES: Dhimitër Kalici, i biri i Janit dhe i Athinas, i datëlindjes 03.03.1966, lindur në Himarë, Vlorë dhe banues në Borsh, Bashkia Himarë, përfaqësuar me prokurë nga avokat Flamur Lazaj.

PALE E PADITUR: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë.

PERSONA TË TRETE: Parashqevi Vejtati, Jorgo Këllici, Ana Qitjazi, Alketa Jorgji

OBJEKTI: 1. Pavlefshmërinë e shkresës Nr. 16413 Prot, datë 06.11.2024 të të paditurit ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë. Anullimin e regjistrimit në bashkëpronësi sipas printimit të III në pasurinë Nr.62, volumni 4, faqe 16, zona kadastrale Nr.1253 Borsh, Sarandë.
2.Regjistrimin sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi Nr.330 datë 01.10.1995 të kryefamiljarit Jani Këllici sipërfaqen 2000 m² pemëtores me kufizimet përkatëse, në pasurinë Nr.62, volumni 4, faqe 16, zona kadastrale Nr.1253 Borsh, Sarandë.

BAZA LIGJORE: Neni 32, 153, 154 të Kodit të Procedurës Civile. Ligji Nr.111 datë 07.02.2019 "Për Kadastrën".

Shtetësja **Parashqevi Vejtati** janë palë në këtë gjykim me cilësinë e personit të tretë dhe nga fletë-thirrja e dërguar nga Gjykata, në adresën e përcaktuar në kërkesë padinë e paraqitur nga pala paditëse, rezulton se ndodhet larguar. Për sa më lart, Gjykata vendosi të bëjë njoftimin e të paditurit me shpallje konform përcaktimeve të bëra në nenin 133/a të Kodit të Procedurës Civile (i ndryshuar), duke e afishuar kopjen e aktit të njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe në faqen zyrtare të internetit të gjykatës (në të cilën do të gjykohet



kërkesë padia), në vendin e afishimit ku pala e tretë ka pasur vendbanimin e fundit, atë të përcaktuar në certifikaten personale.

Seanca gjyqësore do të zhvillohet më **datë 21.01.2026, ora 09:30.**

Kjo shpallje zë vendin e njoftimit për palën në mungesë.

Ju lutemi konfirmoni afishimin e shpalljes në vendin përkatës të afishimit në Bashkinë Delvinë, me vulën përkatëse të kësaj Bashkie.

Kjo shpallje, sipas nenit 133 të K.Pr.Civile (i ndryshuar) duhet të qëndrojë e afishuar jo më pak se 20 ditë pranë Bashkise Delvinë.

**GJYQTARE
ANISA XAKE**

